

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission in
Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies au
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

T R A N S K R I P T

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS,
TË MBAJTUR MË 18 DHJETOR 2003

PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA,
ODRŽANE 18. 12. 2003. GODINE

DHJETOR - DECEMBAR
2003



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

RENDI I DITËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Buxhetin vjetor të konsoliduar të Kosovës dhe përvetsimet për periudhën 1 janar deri 31 dhjetor 2004 (2003/34),
3. Shqyrtimi i parë i Projektlegjislacionit për bashkpunimin e Kosovës me Tribunalin Penal të Hagës (2003/27).

ДНЕВНИ РЕД

1. Усвајање записника са претходне седнице,
2. Друго разматрање Нацрта закона о Консолидованом годишњем буџету Косова и захватања за период 1 јануар – 31 децембар 2004 (2003/34),
3. Прво разматрање Пројектлегислатуре о сарадњи Косова са Кривичним Хашким Трибуналом (2003/27).

AGENDA

1. Approval of the minutes from the previous meeting,
2. Second reading of the Draft Law on Consolidated Budget and Appropriations for the period of 1 January to 31 December 2004 (2003/34),
3. First reading of the Project legislation on Cooperation of Kosovo with Council Tribunal of Hag (2003/27).

TRANSKRIPT

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 18 DHJETOR 2003

Seanca plenare e Kuvendit të Kosovës, u mbajt në sallën e Kuvendit të Komunës Prishtinë.

Seancën e kryesoi Fatmir Sejdiu, anëtar i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës. Bashkëkryesues Hydajet Hyseni, anëtar i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës.

Seanca filloi punën në orën 10,00.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Të nderuar deputetë, zoti kryeministër, të nderuar ministra, mirëseerdhët në Seancën e rregullt plenare të Kuvendit të Kosovës.

Rendin e ditës, të propozuar nga Seanca plenare e mbajtur më parë, e keni para veti dhe një pjesë të materialeve. Them kushtimisht – një pjesë, sepse një pjesë e njërës pikë të rendit të ditës nuk është bërë gati dhe juve nuk u është dorëzuar me kohë.

Shpreh dëshirën që praktikisht të procedojmë për pikat e përgatitura të rendit të ditës, por paraprakisht kemi një vërejtje.

Përveç pikës së parë – Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar, pika e dytë – Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për buxhetin vjetor të konsoliduar të Kosovës dhe përvetësimet për periudhën 1 janar deri 31 dhjetor 2004 – sa kemi informacione nga Sekretaria – nuk është e gatshme për ta debatuar, meqë Komisioni nuk ka arritur me kohë ta bëjë përgatitjen finale për të pasë një procedim të rregullt dhe meritör.

Unë, pas kalimit nga pika e parë – fillimisht në miratimin e Procesverbalit, do të dëshiroja që këtë pikë, me një sqarim plotësues nga kryesuesi i Komisionit – nëse e sheh të nevojshme – ta shtyjmë për seancën tjetër të Kuvendit, e cila do të jetë seancë e jashtëzakonshme për të hënë më 22 dhjetor 2003.

Propozoj që të procedojmë sipas këtij rendi të ditës, duke patur parasysh atë që theksuam.

Lidhur me Procesverbalin, a ka kush ndonjë vërejtje? Nuk ka.

Nëse keni ndonjë vërejtje lidhur me diskutimet tuaja, mund ta bëni edhe me shkrim.

Nëse nuk keni vërejtje, atëherë konsideroj se pika e parë u miratua.

Urdhëroni, e ka fjalën zoti Sabit Rrustemi.

SABIT RRUSTEMI:

E nderuar Kryesi e punës, të nderuar deputetë, kryeministër dhe ministra,

Unë nuk kam diçka rreth Procesverbalit, por dua t'ia paraqes Kuvendit një njoftim rreth bastisjes që ka ndodhur nga ana e KFOR-it në shtëpinë time me 10 dhjetor. Para 8 ditësh, saktësisht më 10 dhjetor 2003 në dyjvetorin e konstituimit të këtij Kuvendi dhe në ditën ndërkombëtare të të drejtave dhe lirive të njeriut KFOR-i Norvegjez, gjegjësisht njësitë e tij të stacionuara diku në qendër të Kosovës kanë mbajtur nën rrethim 12-orësh një pjesë të lagjes ku unë jetoj – në fshatin Zhegër. Madje, dy herë brenda këtyre orëve, kanë hyrë në shtëpinë time. Rrethimi, por edhe bastisja që ndodhi atë ditë edhe në shtëpinë time dhe në këtë pjesë të lagjes, nuk ishte e provokuar as nga më i vogli shkas në këto katër vite e gjysmë pas luftës. Në rastin tim, madje nuk u mor parasysh as imuniteti i deputetit, përkundër paralajmërimit që bëra dhe kartelën që tregova dhe përkundër faktit se ushtarët vinin nga një shtet me traditë demokratike.

Nuk u mor parasysh as sjellja shembullore e kësaj lagjeje për vite me KFOR-in Amerikan që ishte i stacionuar përballë saj, as pasojat e mëdha të luftës, traumat që nuk janë shëruar ende e gjëra tjera me të cilat nuk do t'ju lodhi shumë. KFOR-i Norvegjez kishte ndërmarrë aksion në kërkim të armëve, aty ku realisht nuk kishte armë; aty ku realisht kishte shtëpi të ringritura pas luftës, apo të meremetuara me forcat vetanake, aty ku realisht bëhet përpjekje për një jetë të re në Kosovën e re dhe ku mund të gjenden libra e çanta shkollarësh, vegla pune e lodra fëmijësh dhe edhe dokumente të këtij Kuvendi meqë ne si deputet e edhe unë nuk kemi zyre dhe mundësi për t'i lënë ato ku duhet, por nëpër dhoma tona të ngushta.

Mbase shkasi ka qëndruar aty që unë kurrë në jetën time nuk kam aplikuar për armë, as edhe në Kosovën e pasluftës dhe nuk gjendem në listën e atyre që

posedojnë armë me leje, sepse jetën time e kam mbrojtur dhe e mbroj përmes veprimit të drejtë dhe fjalës së hapur e të vërtetë.

Si duket ky arsenal i armatimit modern me libra, çanta shkollarësh, vegla pune e lodra fëmijësh, shtuar këtu edhe ndonjë krijim timin – paska krijuar bazë dyshimi te organi më përgjegjës i sigurisë dhe u dashka për t'ma prishur mua gjumin, fëmijëve të mij dhe kësaj lagje që në 5 e gjysmë të mëngjesit në mënyrë që realisht atje ku janë armët – nja 5-6 kilometra në afërsi të Gjilanit, kuptohet nëpër vendbanimet serbe – të flihet qetë dhe pa drojë. Sepse, të kontrollosh atje për armë është rrezik, po shprehem kështu me fjalët e ushtarëve që zbatuan këto bastisje, që është edhe bindja ime dhe gjithëherë u dashka për t'u trazuar dhe lënduar ata që janë mësuar me trazime dhe lëndime. Por, më shumë se kjo më ka shqetësuar përbuzja e një imuniteti që, po e them para jush, është imunitet i rremë, që nuk përfilllet por shikohet me përqeshje edhe nga segmentet tjerë të jetës në Kosovë, dhe edhe heshtja dhe mosgatishmëria për t'u mbrojtur ky imunitet dhe i zgjedhuri yt.

Andaj, zonja dhe zotërinj, ose duhet të kemi imunitet të qëndrueshëm – përderisa jemi këtu ku jemi, ose publikisht duhet hequr dorë nga ky imunitet i rremë dhe mashtrues. Rasti im nuk është i pari në këtë Kuvend, a sinqerisht - dëshiroj të jetë i fundit. Ju falemnderit.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Falemnderit. Edhe pse nuk ishte rreth rrendit të ditës, mendoj është një shqetësim i përgjithshëm sikur edhe në disa raste të mëhershme që kjo punë ndodhë dhe apelojmë për një kujdes të posaçëm, sidomos në relacion me të zgjedhurit dhe gjithë qytetarët e Kosovës në kuptimin e trajtimit të tyre në baza normale dhe të ligjit. Zoti Kurteshi, në emër të grupit parlamentar?

ISMAJL KURTESHI:

I nderuari zoti kryesues, deputetë të nderuar, zoti kryeministër, ministra,

Më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës të propozoj që në këtë Seancë, ose më së voni në Seancën e ardhshme të Kuvendit të Kosovës të futet në rend të ditës si çështje urgjente diskutimi rreth lejimit nga ana e UNMIK-ut të zgjedhjeve dhe hapjen e vendvotimeve në territorin e Kosovës për zgjedhjen e përfaqësuesve të institucioneve të Serbisë të organizuara nga Serbia.

Të gjithë e dijmë që zgjedhjet e organizuara viteve të fundit nga Serbia për organet e saj udhëheqëse UNMIK-u i ka lejuar të shtrihen edhe në Kosovë, përkundër faktit se ato organe nuk kanë asnjë ndikim të drejtpërdrejtë në Kosovë dhe se Kosova i ka institucionet e saj demokratike, të cilat – bashkë me UNMIK-un – e udhëheqin Kosovën.

Ndaj këtij veprimi të pakuptimt, të dëmshëm dhe të papranueshëm nuk kanë reaguar deri më tani as institucionet vendore, edhe pse kudo në botë zgjedhjet organizohen vetëm në territorin mbi të cilin organet e dala nga ato zgjedhje kanë kompetenca për të qeverisur me atë territor, gjë që në rasti konkret nuk mund të ndodhë. Ky fenomen vetëm po ringjallë shpresa të rrejshme të Beogradit zyrtar te pjesëtarët e minoritetit serb për okupimin e Kosovës. Ky fenomen po i iriton shqiptarët e si pasojë po i rritë tensionet ndëretnike dhe po e pengon integrimin e minoritetit serb si dhe zhvillimin e proceseve demokratike në Kosovë.

Andaj, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës kërkon që Kuvendi ta shtrojë këtë çështje për diskutim dhe të marrë qëndrim në lidhje me këtë fenomen të dëmshëm për Kosovën. Ju falemnderit.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Të falemnderit zoti Kurteshi. Mendoj se propozimi juaj ishte që të futet në këtë apo në seancën e ardhshme kjo çështje. Mendoj se Kryesia do të takohet dhe do ta ketë këtë parasysh dhe të debatojmë sipas rendit që do të përcaktohet.

Urdhëroni, nëse e keni lidhur me rendin e ditës, Kërstoviq? Nuk është kjo punë replike, nuk ka pasë aludim as emra as kurgjë, dhe ky është një proces i përgjithshëm. Nëse keni për rendin e ditës, urdhëroni?

DRAGIŠA KRSTOVIĆ:

Gospodo iz Predsedništva, dame i gospodo poslanici,

Ja sam prilično razmišljao da li da se javim posle izlaganja poslanika koji je prvi izašao za ovu govornicu i jednostavno stavljam ozbiljnu primedbu na način kako se rukovodi ovom sednicom i kako se dozvoljava da se za ovom govornicom govori nešto što nema veze sa dnevnim redom.

Gospodin, koji je prvi bio za govornicom, je jednostavno iskoristio govornicu za nešto sasvim lično, a osim toga je postavio i pitanje imuniteta i tumačio ga je na svoj način i ne bih rekao da je to tumačenje u skladu sa Poslovníkom i u skladu sa Ustavnim okvirom i pitanje imuniteta ne može da se tumači na taj način i tako

široko. Strogo je rečeno u Poslovniku šta je imunitet poslanički i kako se on upotrebljava i do koje granice štiti poslanike za ono za šta ih štiti.

A što se tiče ovih drugih stvari, koje je gospodin Kurteši izrekao oyde, mislim jednostavno – gospodine predsedavajući, da ste bili u obavezi da zaustavite i jednu i drugu priču. U ostalom mislim da to nisu ni hitna pitanja, niti su pitanja o kojima treba da raspravlja ova Skupština.

Prosto me iznenadjuje da ste dozvolili i na kraju ste sa odobravanjem podržali i jedno i drugo izlaganje. Ja, mislim ako bi smo krenuli redom da ovu Skupštinsku govornicu koristimo svako za svoj slučaj, za svoja neka pitanja, onda bi smo mi ovu govornicu... ne bi smo mogli da je oslobodimo za neke druge stvari gotovo nikad, jer svako od nas ima neke probleme i neke nevolje i neke muke, pa ajmo sada da krenemo da ovu govornicu koristimo za te stvari.

Ja vas molim da iskoristite poziciju koju imate i da sprečite ovakve stvari. Dakle, što se tiče gospodina Kurtešija i njegovog predloga ja se apsolutno protivim tome u ime Poslaničke grupe Koalicije «Povratak» i nadam se, nadam se da to pitanje neće doći na dnevni red ove Skupštine, a ako, kojim slučajem dodje – imaće verovatno sudbinu da će završiti neslavno kao i mnoga druga pitanja. Hvala.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Të falemnderit. Ne nuk jemi ata që paragjykojmë. Ju lutem, nuk keni nevojë, nuk jemi ata që i paragjykojmë debatet dhe është çështje e deputetëve të shtrojnë çështjet. Ju falemnderit.

Të vazhdojmë, ju lutem. Zoti Kurteshi, ta keni parasysh këtë. U krye.

Pra, procedojmë mëtej. Mendoj se ndoshta edhe nuk ka nevojë sqarimi, por nëse kryetari i Komisionit insiston, le të urdhërojë rreth pikës që ka qenë e para – e dyta e shtruar për buxhetin dhe të vendosim, sepse është i papërgatitur natyrisht.

HAKI SHATRI:

Të falemnderit zoti Kryesues. Të nderuar kolegë deputetë, i nderuar kryeministër dhe ministra të pranishëm,

Dola këtu në emër të Komisionit për buxhet dhe të Komisionit për ekonomi e financa të jap një sqarim.

Meqë në shqyrtimin e Projektligjit për buxhetin për vitin 2004 kemi punuar së bashku dhe tërë punën e kemi bërë së bashku, e po ashtu, edhe propozimin për shtyrje të kësaj pike të rendit të ditës e kanë bërë së bashku të dy komisionet në mbledhjen e datës 15 dhjetor me arsyetim se materia që përmbanë ky Projektligj është tejet e rëndësishme për Kosovën, se materia është mjaft e ndërlikuar, se procedura e nxjerrjes së këtij ligji është mjaft e komplikuar në kuptimin e dualizmit të autoritetit vëndimmarrës në këtë sferë dhe duke marrë parasysh tërë këtë ndërlikueshmëri dhe kohën shumë të shkurtër që e kanë pasë komisionet e Kuvendit për ta shqyrtuar këtë materie kaq të rëndësishme, komisionet kanë punuar vazhdimisht dhe të themi gati çdo ditë dhe në bashkëpunim me propozuesin e Projektligjit, konkretisht Ministrinë për Ekonomi e Financa dhe në datën 15 dhjetor kanë konstatuar se materiali nuk mund të rrumbullakësohet ashtu siç dëshironim ta bënim për këtë rast dhe propozuam që kjo pikë e rendit të ditës për sot të heqet nga rendi i ditës dhe të shtyhet për një datë të arsyeshme. Ne kemi menduar që kjo të bëhet për 22 dhjetor dhe kemi menduar se Kryesia do ta gjejë të arsyeshme datën e mbajtjes së një seance të veçantë për këtë çështje.

Mendoj se është mirë që ky propozim të votohet e të përkrahet edhe nga deputetët dhe të caktohet një seancë e veçantë për këtë çështje që do të mbahet në një ditë tjetër, por afati i fundit mund të jetë 22 dhjetori. Ju falemnderit shumë.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Të falemnderit. Edhe pse s'është e zakonshme të zgjasim debatin, por le të urdhërojë edhe kryetari i Grupit Parlamentar të PDK.

ARSIM BAJRAMI:

I nderuar kryesues, zoti kryeministër, të nderuar ministra, të nderuar kolegë,

Edhe unë mendoj se çështja duhet të shtyhet meqë nuk është përgatitur, por të gjithë jemi të vetëdijshëm se sa është azhur çështja e buxhetit dhe duhet gjithësesi ndoshta edhe në një mbledhje të jashtëzakonshme para 31 dhjetorit të jetë i miratuar buxheti.

Mirëpo, unë shfrytëzoj prezencën edhe të kryeministrit edhe të ministrave që kanë sponsorizuar këtë buxhet për të kërkuar disa sqarime.

Sivjet buxheti po përgatitet si një Projektligj, si një Projektligj i propozuar nga Qeveria e Kosovës dhe kjo është shumëpozitive, pra një avancim dhe një rritje e

autoritetit të Qeverisë. Unë kërkoj sqarim se a është Qeveria, dhe Ministria, e lirë vetë për të përcaktuar parametrat financiar apo është e kufizuar nga UNMIK-u? Për shkak se në mbledhjen e kaluar, në emër të Grupit Parlamentar kam kërkuar nga sponsoruesi që të rishqyrtojë disa pozicione, sidomos pozicionin që ka të bëjë me Trupat Mbrojtëse të Kosovës dhe të rrisë, të dyfishojë mjetet. Siç e dini, Trupat Mbrojtëse të Kosovës edhe e kanë bërë një kërkesë që buxheti i tyre të dyfishohet. Dhe, në qoftë se Trupat Mbrojtëse të Kosovës mbikëqyren nga Përfaqësuesi special i Sekretarit të përgjithshëm, nuk besoj se kjo mbikëqyrje përfshinë edhe financimin, në qoftë se Qeveria del me tezën se ajo po e përcakton buxhetin. Dhe nuk mendoj se ky kontroll ndaj TMK përfshinë edhe kontrollin se si duhen ata njerëz të ushqehen, të veshen, të pajisen dhe mendoj se kjo është edhe një përgjegjësi e institucioneve të Kosovës. Andaj, kisha lutur ministrin që ta rishqyrtojë mundësinë e korreksioneve në këtë segment të buxhetit dhe të dalë me një propozim.

Njëkohësisht kam propozuar dhe po rikonfirmoj edhe një herë propozimin e Grupit Parlamentar që të shqyrtohet edhe mundësia e rritjes së mjeteve për arsim, dhe atë për të gjitha nivelet, në mënyrë që të gjendet një zgjidhje sistemore e cila në një mënyrë do t'i mënjanonte mundësitë e shfaqjes së pakënaqësive që janë të rëndomta në fillim të viteve shkollore. I di kufizimet, por në qoftë se Qeveria ka sponsorizuar këtë Projektligj dhe në qoftë se ky Projektligj është i Qeverisë, atëherë Qeveria duhet t'i ketë edhe këto kompetenca për të lëvizur këto pozicione. Unë jam i vetëdijshëm se këtu UNMIK-u nuk do të rrijë anash, por në qoftë se kemi hyrë në këtë punë, atëherë vërtetë të demonstrojmë edhe një lloj autoriteti që duhet ta kemi.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Të falemnderit zoti Bajrami. Sipas kësaj, kemi pra edhe propozimin nga Kryesia e punës edhe të mbështetur nga përfaqësuesi i Komisionit dhe grupet parlamentare që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për seancën e ardhshme, në të cilën natyrisht do t'i kemi materialet e përgatitura dhe vendimin meritor të Kuvendit.

Pyes – a pajtohet Kuvendi? Ju falemnderit.

Konstatoj se me shumicë votash u miratua propozimi.

Pika në vijim është: - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për bashkëpunimin e Kosovës me Tribunalin Penal të Hagës.

Materialet e Projektligjit i keni marrë me kohë, e po ashtu edhe arsyetimet apo arsyeshmërinë për një projekt të tillë.

Sot prezent kemi kryeministrin e Qeverisë së Kosovës, zotin Bajram Rexhepi dhe dëshirojmë t'ia japim fjalën dhe ta dëgjojmë ekspozenë e tij.

BAJRAM REXHEPI:

Të nderuar kryesues të Kuvendit, të nderuar deputetë,

Qeveria e Kosovës ka ndërmarrë iniciativën për përgatitjen e Projektligjit për bashkëpunim të Kosovës me Tribunalin Penal të Hagës.

Përgatitja e këtij Projektligji është nxitur nga një varg arsyesh. Jemi nisur nga maksima juridike se të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe konform kësaj maksime duhet të sigurohen parakushtet e duhura, që të gjithë qytetarëve të Kosovës t'iu mundësohet të jetojnë të lirë e të sigurtë dhe mbrojtja ligjore në rast të përballjes me akuza para gjyqit. Jemi nxitur në përgatitjen e këtij Projektligji gjithashtu edhe nga nevoja që të pengohen sjelljet dhe veprimet arbitrare të organeve të ndjekjes dhe jo vetëm të tyre. Jemi nxitur gjithashtu edhe nga aktualiteti kosovar i cili mbështetet në faktin se Kosova është e gatshme të ballafaqohet me të gjitha sfidat që paraqiten si pengesë në sigurimin e mirëqenies së njerëzve dhe zbatimin e të gjitha lirive dhe të drejtave të garantuara me aktet juridike relevante si vendore ashtu edhe aktet ndërkombëtare.

Ky Projektligj është përgatitur me pjesëmarrjen aktive të ekspertëve mjaft të shquar vendor, duke mos lënë anash edhe ndihmën, përkrahjen dhe bashkëpunimin e ekspertëve ndërkombëtar në Zyrën ligjore të UNMIK-ut.

Në këtë Projektligj përmbushet edhe një pjesë e obligimeve që dalin nga Korniza kushtetuese për vetëqeverisje të përkohshme të Kosovës, përkatësisht dispozitës 5.7 që përcakton obligimin e harmonizimit të akteve vendore me ato ndërkombëtare. Po ashtu, ky Projektligj është i bazuar dhe harmonizuar edhe me Statutin e Tribunalit të Hagës dhe rregulloret tjera të procedurës së Tribunalit të Hagës.

Projektligji shprehë gatishmërinë e institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes së Kosovës për të bashkëpunuar me Tribunalin e Hagës dhe kryerjen e obligimeve që burojnë nga Rezoluta e Këshillit të Sigurimit Numër 827/1993.

Ky Projektligj i mundëson Kosovës që drejtpërdrejt të vazhdojë kontributin në vendosjen e paqës dhe stabilitetit në rajon. Gjithashtu, përmes këtij Projektligji synohet vendosja e bashkëpunimit me Tribunalin e Hagës pa anashkalim të institucioneve vendore dhe me një rol përmbajtësor të këtyre institucioneve.

Projektligji në mes tjerash përmbanë dispozitat për:

- sigurimin e kushteve teknike dhe lehtësimin e punës së Zyrës së Tribunalit Penal të Hagës, e cila vepron në territorin e Kosovës;
- transferimin e procedurës penale në Tribunalin Penal të Hagës, ku vepra hyn në kompetencë të Tribunalit Penal të Hagës;
- ndalimin e gjykimit të serishëm pranë organeve kompetente të Kosovës, atëherë kur kryesi një herë është gjykuar dhe është vendosur rasti nga Tribunali Penal i Hagës;
- ekzekutimin e kërkesës së Tribunalit Penal të Hagës për dorëzimin e të pandehurit;
- afrimin e ndihmës juridike Tribunalit Penal të Hagës që do ta bëjnë organet kompetente të Kosovës, duke përfshirë edhe gatishmërinë për lidhjen e marrëveshjeve që kanë të bëjnë me ekzekutimin e dënimit të shqiptuar.

Mbështetur në atë që theksova më lartë, konsideroj se Projektligji rregullon çështjet komplekse dhe në veçanti bashkëpunimin reciprok në procesin e ndjekjes dhe shqiptimin e dënimit të kryerësit për vrasje të qëllimta, torturë apo trajtim çnjerëzor, deportim i jashtëligjshëm, marrje peng të civilëve, e tjera. Me këtë, Kosova njëkohësisht vazhdon përfshirjen e saj në zhvillimin e rendit juridik ndërkombëtar dhe integrimet evro-atlantike.

Prandaj, të nderuar deputetë, ju propozoj që ta aprovoni këtë Projektligj, i cili do të jetë në funksion të zbatimit të drejtësisë.

Ju falemnderit.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Të falemnderit zoti kryeministër.

Dëgjuat fjalën e kryeministrit. Debati i sotëm lidhur me këtë Projekt është në parim dhe natyrisht në faza të mëtejshme do të procedohet sikur edhe me të gjitha aktet tjera të përcjella nga Kuvendi.

Për diskutim është paraqitur, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike deputeti Alush Gashi. Urdhëroni, e keni fjalën.

T'ju informoj se prezent në sallë janë 82 deputetë. Ju falemnderit për prezencën.

ALUSH GASHI:

I nderuari kryesues, zoti kryeministër, deputetë të nderuar,

Një vërejtje, apo një prej vërejtjeve parimore fillon që nga ajo se si është paraqitur kjo në rend të ditës. Në rend të ditës, të cilin ne e kemi marrë, flitet për shqyrtimin e Projektlegjislacionit. Nuk shkruan që është: shqyrtimi i parë i Projektligjit. Ndërsa, nga i nderuari kryeministër ne dëgjojmë për Projektligj. Në këtë material, i cili na afrohet këtu, përshkruhet një procedurë pak më ndryshe se sa procedurat të cilat ne i kemi gjatë miratimit të ligjeve.

Andaj, kërkojmë sqarime – pse lidhur me këtë çështje ne nuk miratojmë ligj por përdoret një term krejt tjetër.

E dyta. Në Grupin Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës e kemi shqyrtuar, me shumë vëmendje këtë çështje. Dhe rekomandimi i trajtimit të kësaj çështjeje dallon prej trajtimit të projektligjeve dhe ligjeve që ne i miratojmë.

Këtu, në mes tjerash sygjerohet – që ne këtu mund të japim amendamente, që t'ia përcjellim Qeverisë e Qeveria amendamentet t'ia përcjellë Përfaqësuesit special. Mendoj se kjo nuk është një rrugë e cila përkon me procedurat e Kuvendit të Kosovës.

Ne, na vjen mirë që është në materie e paraparë të përfillen ligjet e Kosovës të miratuara këtu. Por, edhe në këtë tekst kemi probleme sepse këtu çështja e kompetencës supreme që definohet si organi kompetent, mendoj nuk është e qartë. Jemi të interesuar ta dijmë se cili është ai organ kompetent? Ai organ kompetent duhet të përcaktohet me ligj. Nëse këtu paramendohet se aktualisht është Përfaqësuesi special i Sekretarit të përgjithshëm – kush do të jetë nesër?

Mendoj se, zoti kryesues, kjo materie duhet të trajtohet sipas procedurave të rregullta, të jetë leximi i parë, puna në komisione, leximi i dytë, votimi dhe pastaj të shkojë në procedurë të mëtutjeshme për miratim eventual. Ju falemnderit.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Ju falemnderit, zoti Gashi. Fjalën e ka Arsim Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar të PDK.

ARSIM BAJRAMI:

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës i jep mbështetje parimore kësaj nisme dhe kërkojmë që, para se të shqyrtohet ligji në leximin e dytë, të sqarohen disa çështje.

Çështja e parë, ajo që u ngrit, është çështja e natyrës së aktit. Vërtetë në propozimin formal që i ka ardhë Parlamentit propozohet shqyrtimi i Projektlegjislativit, pra një akti që nuk dihet a është rregullore e UNMIK-ut a është ligj i Kuvendit të Kosovës. Dhe mendoj se ky Kuvend nuk ka nevojë për t'i shqyrtuar rregulloret e UNMIK-ut. Rregulloret e UNMIK-ut i bie Përfaqësuesi special dhe propozoj që ky akt të quhet ligj. Ligj, dhe t'i nënshtrohet procedurës së rregullt ligjvënëse, pra – leximi i parë; leximi i dytë dhe procedurave të tjera.

Nevoja për këtë ligj është e justifikueshme meqenëse Kosova përmes këtij ligji po institucionalizon bashkëpunimin e saj me Tribunalin e Hagës. Pra ky bashkëpunim që deri më tani nuk ka qenë i institucionalizuar tani po institucionalizohet dhe Kosova po bëhet një lloj partneri me Tribunalin e Hagës që është shumë pozitive, duke pasur parasysh edhe problemet që janë paraqitur më herët, sidomos problemet rreth rastit Limaj, kur një dorëzim apo një paraqitje vullnetare e tij në Tribunalin e Hagës u kualifikua si një arrestim dhe për këtë nevojë ka nevojë që të kemi këtë ligj i cili përcakton edhe procedurat se si procedohet me kërkesën e Tribunalit të Hagës.

Çështja e dytë që ka mbetur e pasqaruar në propozimin e këtij Projektligji është çështja e autoritetit kompetent. Kush është partner apo autoritet kompetent që të bashkëpunojë me Tribunalin e Hagës? A është Përfaqësues special i Sekretarit të përgjithshëm apo është Qeveria e Kosovës?

Meqenëse Qeveria e Kosovës po sponsorizon këtë ligj, Qeveria e Kosovës duhet të jetë autoriteti kompetent. Dikush mund të thotë: po nuk do të pajtohet Përfaqësuesi Special! Ne po bëjmë ligj këtu për Kosovën dhe mendoj se Qeveria e Kosovës duhet të prezentohet si një partner i cili merr përgjegjësinë për bashkëpunimin me Tribunalin e Hagës.

Ligji në fakt kompletion legjislacionin penal të miratuar kohë më parë dhe mendoj se me këtë po rregullohen shumë çështje të nevojshme të bashkëpunimit me Tribunalin e Hagës dhe atë në tri faza: në fazën parapenale, në fazën e zhvillimit të një procesi gjyqësor pranë gjykatave kompetente dhe involvimit të Tribunalit të Hagës – çështjet e inkriminuara me statusin e tij dhe në fushën e afrimit të ndihmës juridike.

Ajo që është shumë e rendësishme në këtë Projektligj dhe që figuron në dispozitat kalimtare është fakti se ligji parasheh formimin e një zyre të Kosovës pranë Tribunalit të Hagës, që është shumë pozitive. Meqenëse zyre të tilla kanë formuar shtetet tjera, vetëm Kosova nuk ka. Kosova e cila është e involvuar në proceset e Tribunalit nuk e ka këtë zyre dhe është mirë që ligji i ka paraparë që të formohet kjo zyre e cila në një mënyrë do të ketë mundësi edhe të bashkëpunojë drejtpërdrejtë me këtë zyre, por të afrojë - do të thojë - edhe ndihmën e nevojshme juridike për qytetarët e Kosovës.

Dhe, së fundi – mendoj se ky Projektligj duhet të mirret shumë seriozisht në leximin e dytë. Ai vërtetë është shqyrtuar nga një grup i ekspertëve por sponsorizuesi i këtij ligji është Qeveria dhe me amendamente që do të bëhen nga komisionet funksionale mendoj se mund të bëhen disa përmirësime që vërtetë këtë ligj do ta bëjnë një ligj të standardizuar, të ngjajshëm me atë që kanë edhe shtetet tjera.

Ju falemnderit.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Të falemnderit zoti Bajrami. Për diskutim është paraqitur, në emër të Koalicionit «Kthimi» deputetja Liljana Keniq. E keni fjalën.

LILJANA KENIĆ:

Poštovani poslanici, poštovani predsedniče,

U vezi sa ovim zakonom koji je predložila Vlada, mislim da nije potrebno mnogo diskusije i dileme kada se kaže – potrebna saradnja sa Haškim tribunalom.

Saradnja sa Haškim tribunalom naprosto se podrazumeva saradnja koja će biti otvorena, iskrena i potpuna, za rad onih koji su stradali i za rad porodica koje su ostale bez svojih najmiljih.

Koalicija «Povratak» je nedavno predložila da ova Skupština donese rezoluciju o saradnji sa Haškim tribunalom. Dakle, izručiti sve optužene koji su počinili zločine bez obzira na etničku pripadnost.

Ono što bih predočila kao problem u vezi sa ovom regulativom jeste sledeće: Što se u memorandumu Vlade naglašava potreba institucionalne saradnje Kosova sa Tribunalom u vezi sa izvršenim zločinima samo tokom rata na Kosovu. Neshvatljivo je prikrivati zločine koji su počinjeni nad Srbima posle sukoba odnosno posle potpisivanja Kumanovskog sporazuma, posebno što su takvi zločini počinjeni pred UNMIK-om, KFOR-om i ostalim predstavnicima međunarodne zajednice.

Mi se nećemo složiti sa predlogom Vlade da se saradnja odnosi samo na izručenje optuženih za zločine koji su izvršeni tokom rata. Ovakvim pristupom, pored ostalog, otvara se i pitanje neljudskog i uvredljivog odnosa predstavnika Kosovske vlade prema Srpskom narodu.

Problem je i forma koju Vlada predlaže. Mišljenja sam da je regulisanje ove materije... da regulisanje ove materije spada u nadležnost Specijalnog predstavnika Generalnog sekretara. Ova Skupština treba da donese rezoluciju o saradnji sa Haškim tribunalom čime bi pokazala podršku UNMIK-u, KFOR-u da podržava akciju hapšenja optuženih a da se na osnovu takve rezolucije UNMIK odnosno SPGS uz potrebne dopune objavi uredbu kojom će regulisati ovu oblast za koju je inače isključivo nadležan, shodno Poglavlju 8.1. tačke i.i.o.

Treći problem jesu termini koje Vlada koristi i ekspertski tim koji je učestvovao u izradi ovog zakona. Upotreba izraza «samoupravni organi Kosova» umesto «privremene institucije samouprave» ili nekad «javni» nekad «državni tužioc» može se podvesti kao tehnička greška. Ali da se u zakonu u nizu članova govori o autoritetu kao nosiocu saradnje Kosova i Krivičnog tribunala bez konkretnog naziva ko i koju instituciju predstavlja taj autoritet, prosto je neshvatljivo. Možda nam član 9. tačka 9. otkriva da je to Vlada ali se u nastavku Vlada dalje ne pominje nego se opet upotrebljava izraz «autoritet». Valjda ćemo do kraja otkriti ko je taj autoritet.

Moj komentar oko regulisanja statusa predstavnika Kosova pred Tribunalom kao diplomatskih lica i u opšte na član 34. ovog zakona bio bi da se ovakvim predlozima predstavnici Vlade rugaju i UNMIK-u i Rezoluciji 1244.

Šta je sa ulogom UNMIK-a? Da li je SPGS taj nadležni autoritet? Pretpostavljam da će sva ova pitanja koja su ostala nedorečena i mnoga druga pitanja, na kraju i razjasniti.

Ponoviću da je stav Koalicije «Povratak» da regulisanje ove materije je u isključivoj nadležnosti SPGS. Hvala.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

T'falemnderit. Në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputeti Bujar Dugolli, kryetar i Grupit Parlamentar.

BUJAR DUGOLLI:

I nderuar kryesues, të nderuar deputetë,

Nuk ka dyshim se ky Projektligj që është paraqitur sot para Kuvendit të Kosovës është i një rëndësie të veçantë dhe mund të them se edhe ky Projektligj si shumë ligje tjera i kanë munguar Kosovës dhe mungesa e tyre i ka kushtuar shumë, sidomos për lëminë të cilën ne sot po e diskutojmë.

Ne, edhe më herët, edhe si institucione edhe si Kuvend jemi deklaruar probashkëpunimit me Tribunalin e Hagës, por këtë e kemi precizuar edhe me një dekalratë të mëhershme se ky bashkëpunim duhet të ekzistojë dhe funksionojë konform ligjit që do ta miratojë Kuvendi i Kosovës. Dhe është një punë e Qeverisë, me ndihmën e atyre ekspertëve që janë cekur që Kuvendit i kanë sjellë një diskutim parimor Projektligjin, sepse unë ashtu po dua ta quaj dhe jo ashtu siç figuron – legjislacion, sepse ne miratojmë ligje, që rregullon këtë materie.

Jemi dëshmitarë të veprimeve të pasluftës në Kosovë se Tribunali i Hagës nuk i ka rrespektuar institucionet e Kosovës dhe qytetarët e Kosovës që janë akuzuar nga Tribunali i Hagës. Ky mosrrespektim konsiderojmë vinte për shkak se ne nuk kishim më parë të miratuar ligjin e Kosovës për bashkëpunim me Tribunalin e Hagës dhe Tribunali i Hagës njihte ligjin e Serbisë për bashkëpunim me Tribunalin edhe mbi territorin e Kosovës, gjë që për ne është një absurd i llojit të vet dhe që ende mbetet absurd që nuk është zgjidhur.

Shpresojmë se pas miratimit të këtij ligji gjërat në këtë fushë të ndjeshme do të ndryshojnë pozitivisht.

Ne kemi vërejtë se sponsoruesi i këtij ligji, si duket, prapë nuk ka patur guximin e duhur të hartojë një projektligj që do t'u jipte institucioneve të Kosovës, Kuvendit dhe Qeverisë rolin që duhet ta kenë për këtë çështje, të paktën ashtu siç e kanë vendet e Ish-jugosllavisë.

Vazhdimisht në tekstin, pra roli vendimtar në Projektligj, siç është paraqitur në Kuvend, i jipet në thojza “një autoriteti kompetent” i cili shprehet pothuaj në të gjitha nenet e këtij Projektligji, është e pakontestueshme nga askush. Dhe shtrohet pyetja – kush është autoriteti kompetent. A është Qeveria e Kosovës? Në rast se është, duhet të funksionojë. A është UNMIK-u, Hollkeri apo është ndonjë qeveri jashtë Kosovës? Dhe kjo duhet të precizohet në punën tonë të mëtutjeshme.

Kjo normalisht varet nga ne si Kuvend i Kosovës në punën e mëtutjeshme që do ta bëjmë kur ta amendamentojmë këtë ligj konform interesit në rend të parë tonin, të institucioneve të Kosovës dhe normalisht duke përfillur legjislacionin ndërkombëtar, sa i përket kësaj lëmie. Dhe ne ligjin, në rend të parë duhet ta bëjmë të pranueshëm për ne, për institucionet e Kosovës, mandej për UNMIK-un.

Ne, si Grup Parlamentar, i japim mbështetje parimore këtij ligji, por normalisht të gjithë bashkërisht duhet të angazhohemi që me amendamente të precizohet roli i Qeverisë së Kosovës dhe roli i mbrojtjes institucionale i të akuzuarve. Është për keqardhje se vetëm ne kur jemi ballafaquar me këtë realitet kemi filluar të mendojmë se duhet Kosova të ketë një ligj të tillë. Dhe unë mendoj se roli i Qeverisë duhet të jetë ashtu siç është në vendet e Ish-jugosllavisë dhe mbrojtja institucionale e të akuzuarve duhet të jetë një kaptinë e veçantë që duhet të rregullohet me amendamente.

Pra, ne e mbështesim parimisht këtë ligj. Ju falemnderit.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Të falemnderit zoti Dugolli. Për fjalë është paraqitur deputeti Ramadan Kelmendi. E keni fjalën.

RAMADAN KELMENDI:

I nderuari kryesues, të nderuar deputetë dhe ministra,

Më lejoni që, duke mbështetur parafolësit dhe duke u bazuar në parimin e ligjshmërisë, e në kërkesën që askush mbi ligjin, t'i them disa fjalë dhe vërejtje.

Para se gjithash edhe ligji duhet të jetë i drejtë, i qartë, i kuptueshëm, pa dykuptime, shprehimisht që eliminon interpretimet subjektive dhe që në këtë shqyrtim të propozimligjit për bashkëpunimin e Kosovës t'i parashtroj sygjerimet e mia.

Pa dilemë, Kosova, si shoqëri demokratike, me shumëçka deri më tash ka dëshmuar bashkëpunimin me bashkësinë ndërkombëtare, rrespektimin e lirive dhe të të drejtave njerëzore dhe qytetare dhe ky propozimligj flet argumentueshëm për këtë. Ky propozimligj rreugllon një çështje sa të ndieshme aq edhe të komplikuar dhe komplekse në realizimin – siç janë gjykimet e krimeve të kryera gjatë luftës në hapësirën e Kosovës, dhe jo pas saj.

Propozimligji me plotë të drejtë e klasifikon atë që ka ndodhur në Kosovë si luftë, sepse si e tillë ishte, përkundër tendencave që kjo luftë të trajtohet si konflikt. Natyrisht, megjithë rrespektin për grupin punues dhe vlerën e propozimligjit, është dashur që të përcaktohet me ligj bartësi i bashkëpunimit me Tribunalin Penal të Hagës e jo të lihet përkufizimi i papërkufizuar dhe autoriteti kompetent. Dhe kjo përsëritet në tërë propozimligjin edhe pse kjo nënkupohet, nga se në natyrën e ligjit nuk mund të qëndrojnë nënkuptimet, dilemat dhe interpretimet subjektive. Bashkëpunimi me Tribunalin e Hagës bëhet në forma të ndryshme, por bashkëpunimi ndryshon prej komunikimit i cili është përsëritur këtu në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze. Propozimligji, kur flet për kompetencat e autoritetit kompetent, nuk përcakton se cilat janë masat adekuate për këtë bashkëpunim nga se Tribunali i Hagës nëse nuk përcakton këto masa, atëherë mund të trajtohem se nuk bashkëpunojmë sa duhet ose në nivele të kërkuara. Propozimligji nuk përcakton kushtet kur procedura penale që zhvillohet pranë gjykatave në Kosovë mund të transferohet në Tribunalin Penal të Hagës, si dhe që ndonjë person është gjykuar në Kosovë për një vepër penale për të njëjtën vepër është e padrejtë të dërgohet në rigjykim në Tribunalin Penal të Hagës. Në propozimligj duhet qartaz të përcaktohet shkalla e veprës penale e cila hyn në kompetencat e Tribunalit Penal të Hagës dhe cila vepër penale mund të transferohet.

Vlerësoj se afati i të drejtës për të ushtruar ankesën prej 8 ditësh kundër aktgjykimit për transfer është i shkurtër, jo i drejtë dhe joreal në rrethanat procedurale.

Në këtë propozimligj të bashkëpunimit nuk është përcaktuar se si të veprohet në raste kur gjykata e Kosovës për të njëjtën vepër penale liron apo pushon procedurën në mungesë të fakteve, ndërsa për të njëjtën Tribunali i Hagës kërkon transfer.

Në përjashtim të urgjencës, kërkesës për arrestim të kryerësit të veprës që bie në kompetencat e Tribunalit të Hagës të bëhet me paralajmërim dhe afat të paraqitur si kriter i lajmërimit vullnetar e jo i arrestimit; si dhe arrestimi dhe

ndalimi deri në 72 orë – është i lartë dhe, nëse arrestimi është i pabazë, duhet paraparë dëmshpërblimin për arrestim të tillë.

Vlerësoj se derisa policia është e obliguar të veprojë dhe ta sjellë të dyshuarin, atëherë edhe Gjykata duhet të jetë e obliguar të vendosë me shpejtësi dhe jo të caktojë paraburgime prej 1 deri në 12 muaj.

Duke u mbështetur në praktikën e gjertanishme të bashkëpunimit me Tribunalin Penal të Hagës, në këtë propozimligj është dashur të përcaktohet edhe dorzonia, siguria se i dyshuari nuk do ta lëshojë Kosovën duke e siguruar atë nga cilido organ.

Me propozimligj mbi bashkëpunimin duhet shprehimisht të parashihen shkaqet e shtyrjes së përkohshme për dorëzimin e të akuzuarit në Tribunalin Penal të Hagës për të mos lënë dilema në interpretim dhe në bashkëpunim. Po ashtu, në tekst shprehja “letarrestim” duhet të zëvendësohet me “fletëarrestim”. Si dhe në rastet kur ekzekutimi i dënimeve të Tribunalit të Hagës bëhet në Kosovë duhet të përcaktohet se kush mbulon shpenzimet nga se ligji bën fjalë për format e bashkëpunimit dhe jo për format e ekzekutimit.

Dhe, në fund – në praktikën korrektuese, gjatë vuajtjes së dënimit plotësohen kushtet për zbutje të dënimit, falje të dënimit e tjera – si do të realizohet kjo në forma të bashkëpunimit në mes të Kosovës dhe Tribunalit Penal të Hagës.

Vlerësoj se edhe gjykatësit e Kosovës që gjykojnë vepra penale, të përcaktuara për krime të luftës, për të cilat është kompetent Tribunali Penal i Hagës, të gëzojnë imunitetin e paraparë si gjyqtarë të Tribunalit të Hagës.

Mendoj se këto plotësime do ta begatojnë, nga se ajo që i ngjanë ferrit mbi dhe është padrejtësia dhe ne kërkojmë drejtësi dhe këtë populli i Kosovës e dëshiron. Ju falemnderit.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Të falemnderit zoti Kelmendi. Për fjalë është paraqitur zoti Hydajet Hyseni, anëtar i Kryesisë. E keni fjalën.

HYDAJET HYSENI:

Zoti kryesues, të nderuar deputetë,

Dokumenti që po shqyrtojmë sot është i një natyre të veçantë por edhe i një rëndësie të veçantë aktuale e afatgjate. Po plotësojmë një nga vakumet e shumta ligjore institucionale në relacionin Kosova – komuniteti ndërkombëtar. Është prandaj i kuptueshëm edhe interesimi i veçantë për këtë ndërmarrje me peshë, dhe si të tillë unë e përshëndes dhe mbështes, por është vështirë e kuptueshme pse edhe ky dokument na vjen me lëshime me mospërputhje përmbajtësore terminologjike, madje edhe në vetë titullin. Diku “ligj”, diku “legjislacion”, e diku – vëni re: “rregullativë”. Anglisht flitet për “draft”, serbisht “nacrt”, kurse shqip “propozim”. Dallimin e vëreni! Shqip flitet, në pasusin vijues për “shkelje të rënda”, anglisht “vajolejshen” mund të jetë aty dikund, kurse serbisht – vëni re, përsëri: “prekrshaj”. Të tilla vërejtje ka shumë. E pakuptueshme në çdo gjuhë, dhe mendoj për çdo logjik është - krijimi me këtë ligj i njëfarë fantom autoriteti komptent për të cilin u fol këtu, i cili pastaj do të mund të themelojë komitete e grupe tjera të posaçme, po aq të paqarta. Nuk merret vesh fare kush i krijon këtofarë autoritetesh të pazakonshme, me ç’kriterë dhe në ç’funksion.

Është edhe më e pakuptueshme, për mendimin tim, rregulla krejt e parregullt sipas të cilës – për këtë legjislacion – “nuk do të ketë votim në Kuvend, por vetëm komente e amendamente të cilat nëpërmjet Qeverisë do t’i përcillen Përfaqësuesit special që të njëjtat t’i ketë në konsiderim gjatë procedurës finalizuese”. Pyes: çfarë rregulle është kjo? Çfarë modeli demokratik? Çfarë praktike paralementare është kjo dhe cila është baza juridike? Cili akt, cila dispozitë?

Pastaj, nëse u dashka që Përfaqësuesi special ta finalizojë, do të thotë të jetë bartës i këtij dokumenti – pse nuk vjen ai të na informojë dhe ta bindë Kuvendin. Ç’është kjo mënyrë komunikimi me Kuvendin? Pse anashkalohet e s’komunikohet në vijimsi trupi ligjvënës? Komunikimi sporadik në dreka a darka me kryetarin e Kuvendit - më lejoni ta them - nuk është komunikim me Kuvendin. Po - është kompetencë e rezervuar, do të ngutet të thotë dikush, siç edhe u tha. Së pari, edhe po të jetë kështu, shtrohet pyetja: pse atëherë na hidhet topi në për të bërë komente fakultative? Pastaj, edhe po të ketë qenë diçka e rezervuar para s’vitesh, kur nuk kishim institucione – a do të thotë se do të mbetet e tillë e rezervuar edhe kur i kemi këto institucione dhe kur të gjithë flasim për bartjen e kompetencave?

Për më tepër, Korniza kushtetuese, edhe e tillë çfarë është, jo vetëm që nuk përjashton kompetencat e institucioneve tona në këtë fushë, por – përkundrazi. Neni 5.6 u përshkruan shprehimisht institucioneve kosovare, citoj:

“përgjegjësini në fushën e marrëdhënieve me jashtë”. Neni 5.7, “Bashkëpunim ndërkombëtar dhe të jashtëm”, u mor vesh, “në koordinim me Përfaqësuesin special, duke përfshirë arritjen dhe finalizimin e marrëveshjeve”. Ndërkaq, neni vijues - iu përshkruan institucioneve të Kosovës përgjegjësi, vëni re: “për harmonizimin e legjislacionit dhe praktikave të tyre me standardet dhe normat evropiane dhe ndërkombëtare brenda të gjitha fushave të përgjegjësisë me qëllim të caktuar lehtësimin e vendosjes së lidhjeve ekonomike, shoqërore dhe lidhjeve të tjera të popullit të Kosovës me popujt e tjerë evropian me vetëdije se rrespektimi i standardeve dhe i normave të tilla do të zënë vend qendror për zhvillimin e marrëdhënieve me komunitetin evro-atlantik”.

Mendoj se kjo nuk do koment të mëtejshëm. Nëse është fjala për bashkëpunim të Kosovës me dikë, gjithëçka mund të përjashtohet, po jo vetë Kosova, jo Kuvendi i saj.

Sa për vetë tekstin, kam përshtypjen, me vërejtjet që u thanë këtu, se është një tekst i mirë dhe si i tillë mund të përbëjë bazë të mirë për një bashkëpunim të efektshëm. Për të qenë i tillë, mendoj se në qasjen e mëtejshme do marrë parrasysh edhe sa vijon:

Kosova dhe populli i saj ishin viktimë e agresionit të politikave gjenocidale antishqiptare dhe rrjedhimisht Kosova dhe populli i saj janë akuzues dhe jo të akuzuar.

Sa i përket kohës, ligji nuk e përcakton këtë propozim krejt qartë. Por Rezoluta 827 e vitit 93, të cilit ky dokument i referohet, mbulon periudhën prej vitit 91 e këndeje. Mendoj se kjo periudha prej vitit 91 nuk do të duhej lënë anash.

Tre. Rendi kushtetues dhe të drejtat kombëtare e njerëzore të qytetarëve të Kosovës janë rrënuar me dhunë dhe në mënyrë antikushtetuese dhe për pasojë – rrezistenca ndaj një politike të tillë, ka qenë jo vetëm e drejtë por edhe detyrë e obligim qytetar e kushtetues, në përputhje jo vetëm me ish-kushtetutën e Kosovës, e cila shprehimisht e obligon qytetarin e Kosovës, por edhe me dokumentet e mirënjohura ndërkombëtare. Lufta çlirimtare nuk mund të barazohet në asnjë rast, në asnjë mënyrë me dhunën gjenocidale shoveniste.

Katër. Dokumenti i Rambujesë, të cilit i referohet edhe Rezoluta 1244 dhe Korniza kushtetuese, sigurisht duke marrë parasysh sa u tha më lartë, parashohin shpalljen e amnistisë për luftëtarët e lirisë kundër të cilëve është ngritur procedurë penale dhe lirimimin e të burgosurve të pengjeve të luftës.

Dhe, së fundi, një çështje që ka të bëjë më shumë me raportet midis nesh dhe me një prirje po ashtu tejet djallëzore për ta përqëndruar sa për fillim gjithësherrin këtu, midis nesh. Siç dihet vite më parë, rinia dhe intelektualët atdhetar të Kosovës inisuan dhe kurorëzuan me sukses të paparë një lëvizje të gjerë e të

fuqishme të pajtimit dhe zhdukjes së konflikteve dhe hasmërive të së kaluarës, në funksion të një të ardhme të lirë e të lumtur për të gjithë Kosovën. Po në shërbim të një të së ardhme të tillë, të lirë, të pavarur e të lumtur, do të duhej të prirëshim edhe më tej nga filozofia e pajtimit kombëtar, zbutjes dhe zhdukjes së konflikteve e armiqësive të vjetra dhe parandalimit të të rejave, parandalimi dhe mundësimi i formave famkëqia të luftës speciale, në shpifje, trillime, fabrikime faktesh të paqena e dëshmishë të rrejshme. Vetëm nëse bashkëpunojmë siç duhet mes nesh, mund të bashkëpunojmë me sukses edhe me botën.

Ju falemnderit.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Të falemnderit, zoti Hydajet. Fjalën e ka deputeti Smajl Latifi. E keni fjalën.

SMAJL LATIFI:

I nderuari kryesues, të nderuar deputetë,

Ne ende s'kemi argumente bindëse që të besojmë se Tribunali për krime lufte në Ish-jugosllavi me seli në Hagë është institucion i mirëfillt i drejtësisë dhe mbështetet plotësisht në parimet e vërteta të drjetësisë njerëzore. Ne ende kemi në dorë plotë argumente bindëse në funksion të kthjellimit të gjykimit tonë, të cilat i vëjnë në pah elementet komponente dhe veçoritë karakteristike politike të njëanshme në vazhdimsi, posaçërisht kur kemi të bëjmë me rastin e Kosovës dhe qëndrimit të këtij Tribunali rreth saj. Ne do të kemi të drejtë gjithnjë të bëjmë komente po ashtu politike sa kohë që Tribunali dhe puna e tij karakterizohet me qëndrime të pastra politike dhe zbaton praktika që çojnë nga një tendencë tepër të dëmshme dhe të padrejtë dhe një lloj barazvlerësimi midis kriminit dhe kriminelëve me luftën çlirimtare dhe liridashësve. Ne ende kemi të drejtë të themi se Tribunali i Hagës vazhdon të shpërblejë edhe luftën çlirimtare të një populli duke i vënë në bankën e akuzës bartësit e saj. Ata që luftuan për liri e vetëvendosje të kombeve të tyre për drejtësinë e vërtetë vazhdojnë të jenë objekt i përndjekjeve, arrestimeve, gjykimeve, dënimeve nga gjykatat e UNMIK-ut në Kosovë dhe ajo e Hagës. Njëkohësisht nuk është vështirë të konstatohet se Tribunali dhe gjykatat e UNMIK-ut vazhdojnë ta mëshirojnë shtetin, pushtetin, aparatit dhe strukturat vartëse të tij që udhëhoqën në mënyrë të organizuar, të programuar krime, dhunë ç'njerëzore, gjenocid të bazuar edhe në platforma të njohura për ne dhe për ndërkombëtarët. Mbase e tërë kjo gjakderdhje në Kroaci, në Bosne dhe s'fundi edhe në Kosovë nxori edhe domosdonë e krijimit të këtij Tribunali për të ndëshkuar shkaktarët e kriminit dhe kriminelë të vërtetë që mbollën tokën me qindra-mijëra varre të fëmijëve, grave e pleqëve, që nuk lanë gjë të keqe pa bërë kundër popujve me qëllim çfarosjeje.

Në këtë dhunë e gjenocid shtetëror u përfshinë struktura të tëra të organizuara dhe jo 4-5 individ...

(Vërejtje e kryesuesit: Zoti Latifi, fokusohuni rreth projektit, ju lutem. Ju falemnderit).

... Tash, e kam kohën time, profesor. Në Hagë gjendet kryekrimineli Millosheviq me disa bashkëpunëtorë. Kjo është tagri që pagoi shteti dhe pushteti i krimit – Serbia, edhe pse planifikoi dhe dëshmoi praktikisht se pati në dorë planin për zhbërjen e popujve, e popullit shqiptar, prapëseprapë që e qetë, ajo forcoi pozitën ndërkombëtare...

(Vërejtje e kryesuesit: Ka një kërkesë, zoti Latifi të diskutosh më ngadalë, për shkak të mundësisë së përkthimit.)

... duke indoktrinuar edhe Tribunalin dhe inkurajuar atë deri në atë masë sa që, ky i fundit, të ulë në të njëjtën bangë dy projekte, plotësisht të kundërta midis tyre – vetëm disa nga bartësit e kësaj kryevepre ç'njerëzore antishqiptare me luftën çlirimtare që e bëri populli ynë për ta shporrur bishën pushtuese me luftëtarët e lirisë si Fatmir Limaj, Isak Musliu, Haradin Balaj. Qëndrimi i luftëtarëve të lirisë në burgun e Hagës - më shumë se tendencën për të vendosur gurë barazpeshë në mes çlirimtarëve dhe kriminelëve - nuk dëshmon gjë tjetër.

Tribunali i Hagës për krime lufte mjerisht aspak nuk koincidon me Gjyqin e Nyrnbergut. Ky ndoshta është edhe argumenti më i besueshëm që që 50 e sa vite më parë Gjyqi i Nyrnbergut përcaktoi prerazi humbësin e luftës së dytë botërore Gjermaninë duke i dhënë ndëshkimin asaj si shkaktar dhe bartës e dhunës, terrorit dhe padrejtësive ndaj popujve të botës. U ndëshkua edhe platforma edhe struktura që barten mbi supe përpjekjet për ta realizuar filozofinë e papranueshme të nazizmit hitlerian. Ndërkaq, Haga nuk e bëri këtë ende ndaj pushtuesit serb. Gjykohet Millosheviqi me katër-pesë bashkëpunëtorë dhe mbetet e paprekur struktura e tij, e cila u përfshi në mënyrë të organizuar dhe sistematike në ndërmarrjen më të madhe të krimit në këto hapësira.

Projektligji për bashkëpunimin e Kosovës me Tribunalin Penal të Hagës, shikuar në prizmen e rrethanave aktuale politike, me gjasë do ta institucionalizojë rolin politik që luan ky Tribunal, në kushtet e veprimit dhe vlefshmërisë së ligjeve serbo-jugosllave të cilat i legjitimon UNMIK-u dhe i mbronë ato, duke intensifikuar përpjekjet për zbatimin e Rezolutës 1244 dhe duke u mbështetur edhe ky Projektligj në kornizën e saj dhe në kornizën kushtetuese...

(Reagim i kryesuesit: I lus përkthyesit të kenë kujdes për përkthime normale.)

... atëherë mund të themi se Projektligji në fjalë është në favor të atyre që interesat e Kosovës i shohin brenda kufijve të Serbisë, e cila nuk e begaton Kosovën me liri dhe të drejtën për vetëvendosje.

Në bazë të këtij Projektligji dhe në bazë të raportit të forcave që fuqishëm po reflektojnë në Kosovë, gjithnjë në favor të plotësimit të kushteve që ofron procesi politik i udhëhequr nga UNMIK-u, do të mund të themi lirisht se vullneti dhe ndjenja e fortë për liri e shqiptarëve të Kosovës do të jenë po ashtu fatkeqësisht në shënjestër dhe operimi i Tribunalit dhe zyrës së Tribunalit në Kosovë do të anashkalojë fatkeqësisht goditjen e strukturave kriminale serbe që e përgjakën popullin shqiptarë, ua dogjën shtëpitë, ua grabitën djersën e pasuritë.

Zoti na ruajt nga shumë gjyqtarë, autoritete gjyqësore apo kompetente që shumë paqartë përmenden shpesh në Projektligj, që gjykuan e dënuan dje shqiptarët, të cilët vazhdojnë punën e tyre edhe sot në pajtim e dhe me vendimet e këshillit prokurorial dhe gjyqësor, shkurt thënë: UNMIK-ut.

Është vështirë të besohet se ata do të bashkëpunojnë për ta ndjekur e gjykuar krimin dhe kriminelët serb por edhe kolaboracionistët shqipfolës që u vënë krahpërkrah me pushtuesit në luftën terroriste kriminale të Serbisë kundër bashkëkombasve tanë.

Ky Projektligj në esencë, mjersisht, ruan të pacenueshme sanksionet që i ka Kosova nga Rezoluta 1244 dhe korniza kushtetuese që e mbajnë të lidhur statusin e saj politik me unionin Serbi – Mali i zi. Prandaj, vështirë se do të ketë një veprimtari të nevojshme në funksion të ndëshkimit të krimit dhe kriminelëve dhe luftës së bazuar në platformën antishqiptare e edhe po qe se miratohet ky ligj.

Ndërkaq, do të thosha se thelbi i gjithkësaj qëndron në ndryshimin përmbajtësor të bazës juridike të këtij Projektligji. Pra, funksioni i zbatimit efikas të tij do të jetë në pajtim të plotë me drejtësinë vetëm nëse baza e tij juridike është jashtë kornizave dhe interesave të 1244-shit. Vetëm duke u mbështetur në këtë bazë mund të themi se do të ketë rol aktiv në ndëshkimin e krimeve dhe gjenocidit shtetëror të Serbisë mbi Kosovën dhe popullin shqiptar.

Ky Projektligj, i bazuar në korniza, që e mohojnë lirinë tonë, do të vështirësojë seriozisht atë lloj bashkëpunimi për të cilin flitet në Projektligj sepse do të lë anash krimet dhe kriminelët e vërtetë, si strukturat e ushtrisë jugosllave dhe njësitet për operacione speciale të Serbisë, policinë dhe strukturat e organizuara që bartin peshën e krimit kundër shqiptarëve – të cilat në muajin mars 99, kur u

shpall mobilizimi i përgjithshëm përfshijnë edhe pushtetin civil në tërë sektorët e tij dhe angazhimin e tyre në bazë të gjerë. Edhe sot e gjithë ditën, pas të gjitha Atyre masakrave në Reçak, Mejë, Korenicë e fshatra të Gjakovës, Izbicë e Drenicë, Parasellë e në dy Krushat e më shumë fshatra të Rahovecit, në Dukagjin, Llap, Gollak e ku jo tjetër – mijëra civil të paarmatosur, të vrarë e të masakruar, në kohën kur familjet tona jetojnë ende në ankthin e pritjes së njerëzve të tyre...

(Reagim i kyesuesit: Zoti deputet, përpiguni ta rrumbullakësoni, e keni kaluar kohën, ju lutem.)

Në fund jam, edhe një gjysmë minuti.

...të gjallë apo të vdekur që janë disa mijëra, pa gjurmë gjejnë terren të gjithë ata kriminelë serbë – mbase edhe prej tyre ka që janë të kyçur në jetën politike dhe institucionale në Kosovë, duke gjetur mbështetje edhe në faktorin ndërkombëtar në saje të politikës së favorizimit të pakicave që ndjek aktualisht edhe UNMIK-u për një Kosovë të ashtuquajtur multietnike.

Ky Projektligj përmbanë në vetëvete edhe një dilemë të madhe, e cila është e rëndësishme për shqiptarët por edhe për ndërkombëtarët: Ç'porosi do të jepë për peshkopin Artemije i cili bekoj kriminelët e Arkanit në qytetin e Rahovecit, duke i bekuar masakrat kundër shqiptarëve, Mija Gjenoviqin që bashkë me 12 kriminelë tjerë për ironi ikën nga Burgu i Qarkut të Mitrovicës pa i hetuar në thojza «rojet e burgut» të udhëhequr dhe kontrolluar nga UNMIK-u? Ç'porosi do të jepë për kriminelë të shumtë serbë që bënë krime e masakra dhe i shin me detyra dhe funksione të ndryshme, për shembull në Gjakovë: Nikolla Miçunoviq - Dragan, oficer aktiv kapiten; Aleksandar Miçunoviq - Aca, polic; Predrag Miçunoviq; Dragutin Josifoviq - Guta; Muharrem Ibraj ose Muharremi i Mush Jakupit; Mhill Abazi, Marjan Abazi me krimet e bëra ndaj bashkëkombasve të vetë; Sava Stanojeviq, mjek - që vrau me dorën e vet kolegun doktor Izet Hima; Danillo Obradoviq, ish roje e pyllit me të birin; Darko Nedoviq, ish polic; Millutin Novakoviq – Stari, shkaktarë të masakrave në Mejë – Korenicë, pjesëmarrës në të gjitha frontet dhe krimet kundër shqiptarëve; Dragutin Novakoviq, vëllau i tij; Zoran Isajiloviq; Millan Perkoviq anëtarë të shtabit në Gjakovë; Novak Pituliq, komandant i policisë në Gjakovë, ndërkaq Sreten Camoviq, shef i UDB në Gjakovë; Momçillo Obradoviq – Moma, ish kryetar i komunës së Gjakovës dhe Dragutin Premtiq, ish gazetar i “Jedinstvos” janë arkitektët e dhunës dhe të gjenocidit kundër shqiptarëve të kësaj zone, zbatuesit e planit shtetëror për pastrim etnik të shqiptarëve.

Përmenda disa nga emrat e kriminelëve që vepruan në Gjakovë e Rahovec. Të tillë ka shumë. Ata as nuk fshihen, as nuk ikun. Jetojnë ende pa vrikë.

Do ta shfrytëzoj rastin edhe nga kjo foltore për të bërë kallxim penal publik kundër luftës shtetërore kriminale të Serbisë dhe kriminelëve serb, por edhe kundër kolaboracionistëve shqipfolës të cilët, jam i bindur se është shumë e domosdoshme sa më parë që të ndëshkohen kudo që gjenden dhe njëherë e përgjithmonë të pushojnë tendencat për ta kriminalizuar UÇK-ën dhe luftën çlirimtare – pra luftëtarët e lirisë.

Ju falemnderit. Më falë që e zgjata pak.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Për fjalë është paraqitur deputetja Mevlyde Saraçi, le të bëhet gati pastaj deputeti Hasan Metaj. Ju lutem të fokusoheni në materien.

MEVLYDE SARAÇI:

I nderuari kryesues, të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji, siç u tha nga zoti kryeministër, për bashkëpunim të Kosovës me Tribunalin e Hagës e ndërkaq në materialet tona i emërtuar si Projektlegjislacion – kuptohet se ka rëndësi të veçantë për Kosovën, sidomos kur kemi parasysh se edhe katër vite pas përfundimit të luftës ende nuk janë akuzuar të gjithë kriminelët të cilët shëtisin të lirë.

Në mes vërejtjeve tjera, që u thanë nga kolegët, edhe unë po i paraqes vërejtjet e mia. Ndoshta disa edhe do të përsëriten.

Kuvendi, pra, në bazë të Rregullores së punës, amendamentet e dërguara për projektligje i aprovon në seancë plenare dhe jo përmes Qeverisë që t'i dërgohen Përfaqësuesit special. Projektlegjislacioni gjithësesi duhet të krijohet si projektligj, për të kaluar nëpër komisione funksionale dhe të votohet në Kuvend.

Vërejtja ime, është te neni 2, alineja 1 ku nuk është përcaktuar saktësisht kush është ai autoritet kompetent.

Alineja 2, po ashtu te neni 2 thuhet se autoriteti kompetent për të cilin e thash vërejtjen – «me vendim mund të themelojë komitete apo grupe të veçanta për të lehtësuar kryerjen e punëve rreth bashkëpunimit me Tribunalin e Hagës.». Nuk precizohet cilat punë. Është e paqartë dhe duhet gjithësesi të përcaktojë këto grupe apo komitete, të cilësohet aktiviteti i tyre dhe të sanksionohet edhe përgjegjësia.

Në Kosovë ka gjurmë të krimit dhe argumente të mjaftueshme të cilat ende kanë mbetur të pahetuara nga organet kompetente në Kosovë, por edhe nga vetë Tribunali i Hagës, prandaj kjo është edhe arsyeja që kërkoj e të cilësohen këto grupe apo komitete.

Fakti tjetër është se në Kosovë ende nuk janë hapur të gjitha varrezat masive. Gjithashtu kufomat e ekzaminuara ende po qëndrojnë në Serbi dhe po riatdhesohen kohëpaskohe në numër shumë të vogël. Edhe kjo është një formë e kriminalizimit të familjeve që presin zbardhjen e fatit të personave të humbur, e që duhet të formohen këto grupe apo komitete për të hetuar shkaktarët që pengojnë këtë proces.

Ne jemi dëshmitarë se në Kosovë edhe po hapen disa varreza masive pa bashkëpunuar fare me institucionet e Kosovës. Prandaj, ky material, mendoj nuk e meriton sot të aprovohet në parim. Ne duhet të bisedojmë edhe më tutje në bazë të Rregullores së punës, të sjellim vërejtjet tona me shkrim dhe gjithësesi ky të dalë projektligj i amendamentuar dhe i aprovuar nga ky Kuvend. Ndryshe, nuk mund t'i lahemi borxhit popullatës së Kosovës që ka përjetuar krimet më të rënda në historinë e vet.

Ju falemnderit.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Ju falemnderit. Fjalën e ka deputeti Hasan Meta.

HASAN META:

I nderuari kryesues, të nderuar deputetë,

T'ju them të drejtën – unë nuk jam jurist, por si qytetar i Kosovës dhe njeri që kam bukur vjet – nuk mund sot e tash të flasim për Tribunalin e Hagës dhe nuk është në duart tona, por kjo procedurë që e bëjnë ata për njerëzit që kanë qenë të okupuar, që kanë bërë luftë për liri, që kanë bërë luftë kundër gjenocidit, kundër dhunës dhe nuk e kemi menduar se do të akuzohen për Tribunal Hage dhe nuk pajtohemi në asnjë mënyrë dhe asnjëherë që njerëzit tanë të akuzohen në Tribunalin e Hagës dhe nga Tribunali i Hagës për krime lufte.

Ky material, që na ka ardhur sot dhe mënyra e paqartë e tij, çka do të dalë nga ky, a do të dalë ndonjë ligj, a do të dalë diçka tjetër e send – edhe një herë na bën me dije se Qeverisë së Kosovës i mungon ministria përkatëse. Po t'ishte ministria përkatëse, e cila do ta rregullonte këtë materie, nuk do t'na vinte në

këtë mënyrë ky material që, në një mënyrë, krijon edhe huti. Krijon – për deputetët e Kuvendit të Kosovës, e mos të flasin për qytetarët e Kosovës!

Unë, nuk e di pse këto gjëra bëhen kësisoj. E kuptoj dhe pajtohem me të gjithë parafolësit që për qytetarët të cilët do të akuzohen nga Tribunali i Hagës – institucionet kosovare duhet ta marrin përgjegjësinë dhe të qëndrojnë ashtu si duhet, si nëpër shtetet tjera. Por, propozimi do të jetë kësisoj: që ky të vijë si material i duhur nëse duam ligj për këtë dhe t'i ndjekë procedurat e zakonshme, që janë në Kuvendin e Kosovës.

Por, edhe një gjë: është mirë që t'i mendojmë me kohë dhe disa gjëra t'i bijmë me kohë, e mos të vonohemi shumë. Dhe, në anën tjetër, është mirë që ne si deputetë, si subjekte politike, si qytetarë të Kosovës të mendojmë dhe të punojmë që ta krijojmë shtetin e Kosovës dhe të mos manipulojmë me askend, sidomos me qytetarët duke u thënë se jemi shtet, i kemi këto, këto e këto. Për arsye se ne duhet të punojmë.

Nëse ne nuk jemi në gjendje të krijojmë një projekt që të vijmë deri te pavarësia e Kosovës, unë jam i mendimit se duhet ta angazhojmë një institucion të pavarur ndërkombëtar - institut që do t'na krijojë projektin si do të vijmë deri te pavarësia e Kosovës.

Ju falemnderit.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Ju falemnderit. Me këtë shterruam diskutimet përkatësisht debatin në parim. Po ju s'jeni të paraqitur. Në emër të Grupit Parlamentar, çfarë dëshironi, ju lutem? A e keni për projektin, apo keni replikë? Nëse për replikë, s'keni arsye. Po, ju dëgjuat që unë tërhoqa vërejtjen vazhdimisht sikur juve edhe të gjithë tjerëve që të bisedohet rreth temës. Urdhëroni, ç'dëshironi? E keni fjalën dhe urdhëroni...

DRAGIŠA KRSTOVIĆ:

Gospodine predsedavajući ozbiljno zameram zbog ovakvog selektivnog odnosa prema poslanicima, pojedinih poslaničkih grupa...

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Nuk keni arsye, ju lutem. Urdhëroni çfarë keni të diskutoni për Projektin?

DRAGIŠA KRSTOVIĆ:

... Ja ozbiljno protestujem zbog svih onih stvari koje su izrečene za ovom govornicom u vezi Projekta zakona o saradnji sa Haškim tribunalom. Mislim da nimalo nema smisla da se Haški tribunal, kao institucija međunarodna dovodi u pitanje i da poslanici ističu da nisu uvereni da je Haški tribunal institucija pravde.

Mislim da se u ovoj Skupštini, iako se donese zakon o saradnji sa Haškim tribunalom ne može doneti zakon koji neće biti opšti akt. Naprotiv, on mora biti opšti akt i ne može biti zakon predviđen za odgovornost pripadnika jedne nacionalne zajednice i da bude istovremeno zakon koji će štititi pripadnike druge nacionalne zajednice. To jednostavno neće moći iz prostog razloga što će neko ko je ovlašćen tako nešto da spreči.

S druge strane, ova govornica je danas iskorišćena za držanje političkih govora i za promociju određenih politika i u ime Koalicije «Povratak» stavljam ozbiljan prigovor i sa te strane na stav predsedništva i predsedavajućeg i mislim da je to trebalo da se spreči.

Oni koji su osumnjičeni za ratne zločine, učinjene prema albanskom narodu su izručeni Haškom tribunalu ili će biti izručeni i oni se izručuju po zakonu koji je donela Republika Srbija. A jeste! Pa to je tako... Mi smo bili spremni, gotovo smo bili spremni – hvala ljepo - da danas glasamo za, kada je u pitanju ovaj zakon jer smatramo da svi imamo interes – da ostavimo jednu ružnu prošlost iza sebe i da se okrenemo ka budućnosti i da idemo ka toj budućnosti bez ikakvih prepreka i opterećenja koja nas prate iz te neposredne prošlosti.

Mi ćemo, na žalost, prema onome što je rečeno danas ovde, najverovatnije glasati na jedan sasvim drugi način.

Ovo neće biti zakon koji će predvideti samo progon Srba koji su činili zločine. Ovo će biti zakon, ja pretpostavljam da će biti zakon koji će predvidjeti na jedan opšti način progon svih onih koji su na bilo koji način i prema bilo kome činili zločine.

Imao sam utisak iz izlaganja dosadašnjih diskutanata da je... da se ulaže napor da se donese jedan zakon koji će izdvojiti jednu zajednicu i samo progoniti ljude iz te zajednice. To se neće desiti. Ja ne očekujem ni da će ova Skupština moći da prihvati donošenje jednog takvog zakona.

Ako je neko to razumeo da to tako može, onda je to strašna zabluda. I mislim da će se uveriti da je to zabluda onda kada se zakon bude definitivno doneo.

Danas su mnogi iskoristili priliku da budu Haški tužioc i sa ove govornice, pa su mnogi iskoristili priliku da budu istovremeno i tužioc i branioc. Ja vas uveravam da će to biti neko drugi a da zakon treba da bude sasvim nešto drugo. On će, ako se donese kao zakon ili ako se donese kao uredba, biti nešto što će da obavezuje institucije Kosova da saraduju sa Haškim tribunalom. I to će biti prilično teška obaveza. Hvala lepo.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Falemnderit. Me këtë përfunduar debatin.

Ju lutem një koment të shkurtër. Pikërisht, edhe diskutimi juaj është – një pjesë, pikërisht e orientimit politik dhe ka krejt qasje që dëshiron të ngritë tensione të panevojshme në Kuvend. Unë nuk dua ta rrumbullaksoj dhe votimi do ta tregojë veten, qëndrimin e përgjithshëm të Kuvendit rreth një projekti kaq të rëndësishëm për Kosovën, për qytetarët e Kosovës dhe për bashkëpunimin e saj me instancat ndërombëtare, pra edhe me këtë nivel.

Urdhëroni, e ka fjalën Xhavit Haliti, anëtar i Kryesisë.

XHAVIT HALITI:

Zoti kryesues, kërkoj falje që paraqitem pasi, në njëfarë mënyre theksuat mbylljen e diskutimeve, marr fjalën.

Për rëndësinë e nxjerrjes së ligjit nuk domend se pothuaj të gjitha grupet parlamentare u pajtuan se duhet të jetë një ligj. Edhe përfaqësuesit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe çdo ushtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës e ka patur parasysh që në fillim se ekziston një Konventë e Gjenevës mbi ligjet e luftës dhe kanë patur parasysh me rregulloret e tyre që ajo duhet të zbatohet nga çdonjëri, sepse si Konventë nuk është bërë vetëm për Kosovën, as vetëm për Serbinë, as vetëm për Jugosllavinë por është bërë për të gjithë ata që provokojnë dhe shkelin këto ligje të luftës.

Mendoj që, edhe përkundër përpjekjeve tona që ta ligjërojmë i nstitucionalisht përmes Qeverisë së Kosovës këtë ligj, unë më shumë e shoh si një rregullore e cila në njëfarë forme do të kalojë përmes zotit Hollkeri. Megjithatë, mendoj se Zyra ligjore e UNMIK-ut dhe zoti Hollkeri duhet ta kenë parasysh se kosovarët po kërkojnë që ky ligj të institucionalizohet, të akuzuarit të cilët do t'i nënshtrohen Gjykatës së Hagës – kushdoqofshin ata – të jenë të denjëtetshëm dhe të mos shkelen të drejtat e tyre. Çka don të thotë kjo? Në qoftë se një i akuzuar - pra nga Gjykata e Hagës në Kosovë kërkohet - të paralajmërohet dhe

të kemi një shprehje publike pothuaj të të gjitha mekanizmave të subjektit politik dhe ushtarak të Kosovës të cilët janë të gatshëm të përballen me drejtësinë kur ajo e kërkon. Prandaj, mendoj se në këtë fushë do të insistoja dhe kërkoja, në këtë rast nga zoti Hollkeri dhe nga Zyra ligjore e UNMIK-ut që të ketë parasysh denjëtetin e njeriut dhe moshkeljen e të drejtës së të akuzuarve nga përfaqësuesit të cilët janë në ndjekje ose në hetim të individëve.

Ju falemnderit.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Gani, për çka e ke fjalën, të lutem. Jo, jo. A doni diçka lidhur me projektin. Të lutem shkurt, se e përfunduar.

GANI KOCI:

Besoj se nuk do ta konsideroni keq këtë shfrytëzim të foltores.

Unë e kam një propozim kështu që Qeveria do të duhej ta kishte parasysh që në këtë kuadër të bashkëpunimit me Tribunalin e Hagës të përcaktojë detyrat, obligimet dhe përgjegjësitë e saj si Qeveri në mbrojtjen, po them, ose në afrimin e ndihmës juridike dhe financiare në mbrojtjen e të akuzuarve në Tribunalin e Hagës. Kjo nuk është diçka e re, por është se është aplikuar edhe në shtetet tjera që kanë miratuar ligje të tilla dhe unë, me asnjë dispozitë të këtij Projektligji, nuk kam hasë se Qeveria merr një obligim të tillë që të akuzuarve në Tribunalin e Hagës t'u ofrohet një asistencë edhe materiale, edhe juridike, edhe financiare. Prandaj, kjo duhet të jetë pjesë e këtij Projektligji.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Pra, përfunduar debatin. Ishte një debat i frytshëm me propozime konkrete, në parim të themi. Ka ndonjëherë që fokusi ishte jashtë pjesës thelbësore të materies, por është normale, në debatet parlamentare.

Vë në votim në parim pranimin e këtij Projektligji, sipas propozimit të shumicës së diskutuesve të gjertashëm në procedurë.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Një.

Abstenime?

Konstatohet se me shumicë votash për; një kundër dhe njëmbëdhjetë abstenime - ky Projektligj u miratua në parim dhe le të shkojë në procedurë të mëtejshme.

Votimi – Glasanje – Voted:

- Për – Za – ForShumica – Vecina – Majority.....
 - Kundër – Protiv – Against01.....
 - Abstenime – Uzdržani – Abstained.....11.....
-

Ftoj Komisionin për legjislacion dhe Komisionin e buxhetit që të marrin në shqyrtim, në afat të rregullt, dhe t'i japin mendimet e tyre – sikur edhe të gjithë deputetët.

Ju falemnderit.

Pika në vijim është – Propozimi i rendit të ditës për Seancën e ardhshme.

Urdhëro Sanije. Pas vitit të ri, por besoj se do të shihemi në seancën e ardhshme dhe do të mund të japësh propozim.

Një informim i drejtpërdrejtë. Seanca e ardhshme e Kuvendit do të jetë më 22 dhjetor – ditë e hënë, në këtë sallë, në orën 11.

Rendi i ditës do të jetë, si temë bosht:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për buxhetin vjetor të konsoliduar të Kosovës dhe përvetësimet për periudhën janar – 31 dhjetor 2004 – pikë që e shtyem sot.

Kryesia do të ketë parasysh edhe propozimet tjera.

Ju falemnderit.

Seanca përfundoi punën në orën 11,40.

E transkriptoi: - 1-31/RT, Zyra E-04, Tel.038-211-860